



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJETLLËS KANALIZIME VLORË SH.A

Nr._____, Prot.

Vlorë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mirëmbajtje pompash avolzhime”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

42122000-0 – Pompa

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,978,000 (dy milion e nëntë qind e shtatëdhjetë e tetë mijë) Lekë **Pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Sipas kritereve të përgjithshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi duhet të jetë jo më e vogël se 35 % e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 dhe 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendorsja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin e fundit 2026, duke pasur në vëmendje parashikimet e ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", I ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetqeverisjes vendore), për të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas QKB.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % e fondit limit të kësaj kontrate. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetim i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Të disponoj repart avolzhimi për avolzhimin e elektromotorave, të shoqëruar me bango prove, duke bërë hermetizim e tharje të plotë brenda kushteve teknike. Kjo të provohet me kontratë pronësie ose kontratë marrje me qera si e repartit edhe të bankoprovës akt noterial.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë repart avolzhimi të pajisur me bango prove është e nevojshme pasi procesi i avolzhimit të elektromotorëve përfshin çmontimin, rindërtimin e mbështjelljeve elektrike, tharjen, hermetizimin dhe testimin e tyre përpara vënies në funksion.

Bango prova është element i domosdoshëm për verifikimin e parametrave teknikë dhe funksionalë të elektromotorit pas përfundimit të riparimit, duke garantuar që pajisja të rikthehet në punë sipas parametrave të projektimit dhe standardeve teknike.

Për këtë arsye, disponimi i repartit dhe bangos së provës konsiderohet kapacitet teknik minimal i nevojshëm për realizimin e kontratës.

2.3.3 Të disponoj tel me PVC për kryerjen e punës/shërbimit (veshja e jashtme e telit). Të vërtetohet me faturë tatimore, e deklaruar në organet tatimore, për blerjen e telit.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Gjatë procesit të avolzhimit përdoren materiale specifike elektrike, ndër të cilat edhe teli i izoluar me PVC, i cili shërben për realizimin e mbështjelljeve të reja të elektromotorëve.

Kërkesa synon të vërtetojë se operatori ekonomik ushtron realisht aktivitet në këtë fushë dhe disponon materialet bazë të nevojshme për realizimin e shërbimit, duke garantuar vazhdimësinë e punës dhe shmangien e vonësive gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponoj mjete dhe pajisjet e nevojshme teknike në dispozicion apo mund ti vendosen në dispozicion operatorit ekonomik për kryerjen e shërbimit.

Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose qera makineritë dhe pajisjet e mëposhtme:

- Bobinatriçe për avolzhim motorësh
- Furrë për tharjen e peshtjellave pas avolzhimit
- Makineri prerës për materialet izoluese
- Mjet ngritës pirun, vinc)

Për të vërtetuar këtë, mjetet duhet të shoqërohen me dokumentat e mëposhtme:

Kur janë në pronësi duhet të shoqërohen më faturë tatimore, e deklaruar në organet tatimore ose deklarata zhdoganimi, ose cdo lloj forme të parashikuar nga Kodi Civil.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerasë me afat jo më të vogël se sa afati i kryerjes së shërbimit shoqëruar me dokumentat e mjeteve më faturë tatimore, e deklaruar në organet tatimore ose deklarata zhdoganimi, ose cdo lloj forme të parashikuar nga Kodi Civil.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Realizimi i shërbimit të avolzhimit kërkon përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve specifike teknike për çmontimin, matjen, kontrollin, riparimin dhe testimin e elektromotorëve.

Për këtë arsye kërkohet që operatori ekonomik të disponojë pajisjet e nevojshme teknike, në pronësi ose të vendosura në dispozicion, në mënyrë që të garantojë realizimin cilësor dhe brenda afateve të kontratës.

Bobinatriçe për avolzhim motorësh – është pajisje e domosdoshme për realizimin e mbështjelljeve (bobinave) të reja të statorit sipas parametrave teknikë të motorit. Kjo pajisje siguron saktësi në numrin e spiraleve, dimensionet dhe formimin e tyre, duke garantuar performancën dhe jetëgjatësinë e elektromotorit pas avolzhimit.

Furrë për tharjen e pështjellave pas avolzhimit – përdoret për procesin e tharjes dhe polimerizimit të llakut izolues të mbështjelljeve të reja. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar izolim elektrik të qëndrueshëm, mbrojtje nga lagështia dhe rezistencë mekanike të mbështjelljeve, duke shmangur defektet e parakohshme të motorit.

Makineri prerëse për materialet izoluese – nevojitet për prerjen dhe përgatitjen me saktësi të materialeve izoluese që vendosen ndërmjet mbështjelljeve dhe bërthamës së motorit. Përdorimi i kësaj pajisjeje garanton cilësi në izolim dhe respektimin e parametrave teknikë të kërkuar gjatë procesit të avolzhimit.

Mjet ngritës (pirun, vinc ose ekuivalent) – është i nevojshëm për transportimin, lëvizjen, çmontimin dhe montimin e pompave dhe elektromotorëve, të cilët për shkak të peshës së konsiderueshme nuk mund të manovrohen në mënyrë të sigurt me mjete manuale. Disponimi i mjetit ngritës garanton sigurinë e punonjësve dhe shmang dëmtimet e pajisjeve gjatë procesit të riparimit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të ketë të garantuar furnizimin me lëndët e para kryesore që përdoren në procesin e avolzhimit të pompave dhe elektromotorëve, të shoqëruara me dokumentacion teknik

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton se teli i bakrit i emaluar dhe materialet izoluese që do të përdoren në procesin e avolzhimit janë minimumi të klasës së izolimit F (155°C).

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Fatura tatimore blerjeje të lëndëve të para ose kontrata furnizimi me furnitorë të autorizuar;
- Fletë teknike (datasheet), katalogë ose certifikata cilësie të lëshuara nga prodhuesi;
- Deklaratë se gjatë zbatimit të kontratës do të përdoren materiale të reja, të papërdorura dhe me klasë izolimi jo më të ulët se Klasa F (155°C).

Argumentim I: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", sipas të cilit autoriteti kontraktor mund të kërkojë prova mbi aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, duke garantuar se ai disponon burimet dhe kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Kërkesat duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Gjithashtu, rregullat e prokurimit publik lejojnë vendosjen e kërkesave që lidhen me kapacitetet teknike, materialet dhe mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës, kur këto janë të domosdoshme për cilësinë e shërbimit.

Kërkesa për përdorimin e materialeve me **klasë izolimi F (155°C)** është e justifikuar nga natyra e shërbimit të avolzhimit të pompave dhe elektromotorëve, pasi këto aggregate punojnë në kushte ngarkese të vazhdueshme dhe ekspozohen ndaj temperaturave të larta gjatë funksionimit. Përdorimi i telit të bakrit dhe materialeve izoluese me klasë më të ulët mund të sjellë degradim të izolimit, ulje të jetëgjatësisë së motorit dhe rritje të riskut të defekteve. Për këtë arsye, kërkesa garanton që pas avolzhimit elektromotorët të rikthehen në gjendje pune sipas standardeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor dhe të sigurohet qëndrueshmëria e investimit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë minimumi 1 (një) furgon, në pronësi, qira, huapërdorje ose çdo formë tjetër të lejuar nga ligji.

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruar me qera, huapërdorje ose çdo formë tjetër të lejuar nga ligji duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/huapërdorjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5, germa ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Elektromotorët që përdoren në stacionet e pompimit dhe objektet e ujësjellës-kanalizimeve kanë përmasa dhe peshë të konsiderueshme dhe duhet të transportohen nga vendndodhja e tyre drejt repartit të riparimit dhe anasjelltas.

Për këtë arsye kërkohet disponimi i të paktën një mjete transporti tip furgon, i cili siguron kryerjen e transportit të pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për realizimin e kontratës pa krijuar vonesa në shërbim.

2.3.7 Operatori ekonomik të ketë në të stafin e tij ing mekatronik. Për ing mekatronik të paraqitet kontrata e punës, cv, dhe diploma e tij si dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave

2.3.7.1 Operatori të paraqesë një dëshmi nga administratë Tatimore për punësim jo më pak se **4 punonjës ku të jetë përfshirë dhe ing mekatronik**, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi:: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për shkak të ndërthurjes së elementeve mekanikë, elektrikë dhe të automatizimit, prania e një Inxhinieri Mekatronik konsiderohet e nevojshme për të garantuar mbikëqyrjen profesionale të proceseve të remontit dhe avolzhimit, kontrollin e cilësisë së punimeve dhe funksionimin e sigurt të pajisjeve pas ndërhyrjes.

Kjo kërkesë është në përpjesëtim të drejtë me objektin e kontratës dhe nuk krijon kufizim të pajustificuar të konkurrencës, pasi lidhet drejtpërdrejt me nevojën për personel të kualifikuar që disponon njohuri të integruara në fushat mekanike dhe elektrike, të domosdoshme për realizimin e shërbimit sipas specifikimeve teknike dhe standardeve profesionale të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa për të patur të paktën 4 punonjës, përfshirë inxhinierin mekatronik, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimit, i cili përfshin procese të ndryshme pune si çmontimi, avolzhimi, tharja, montimi, testimi dhe transporti i elektromotorëve.

Ky numër minimal punonjësish konsiderohet i nevojshëm për garantimin e kapaciteteve njerëzore të operatorit ekonomik dhe për realizimin e kontratës brenda afateve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike dhe termat e references janë hartuar nga specialist i fushës, i cili ka njohuri të posacme për objektin e prokurimit, i cili është ngritur me urdhër të Titullarit për hartimin e

specifikimeve të teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike janë përcaktuar mbi bazën e karakteristikave reale të motorëve të instaluar në objektet e Autoritetit Kontraktor dhe përfshijnë fuqinë, tensionin, frekuencën dhe numrin e rrotullimeve të secilit motor, me qëllim identifikimin e saktë të pajisjeve që do t'i nënshtrohen shërbimit.

*Specifikimet teknike dhe termat e references, për shërbimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe standardeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit